Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Bujar Nishani

URDHËR
Nr.1394, datë 21.2.2011

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr.8485, datë 15.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 3 dhe 7 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, “a” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Komitetit Shqiptar të Birësimeve jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km të lëshohen nga Drejtori i Komitetit Shqiptar të Birësimeve.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, Drejtori i Komitetit Shqiptar të Birësimeve të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.

3. Ngarkohet Drejtori i Komitetit Shqiptar të Birësimeve, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr.4, datë 23.2.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“ “
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“ “
Vitore Tusha	Anëtare	e	“ “
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“ “
Admir Thanza	Anëtar	i	“ “
Bashkim Dedja	Anëtar	i	“ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“ “
Sokol Berberi	Anëtar	i	“ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 1.7.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 4/1 Akti që i përket:

KËRKUES: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përfaqësuar nga Vjollca Meçaj dhe avokat Fatmir Braka, me deklaram.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj, me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) të ligjit nr.10 192 datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”;

2. Pezullimi i zbatimit të ligjit deri në përfundim të shqyrtimit të kërkesës nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 15, 30, 35, 36, 42, 81, 116, 131, 134 dhe 148 të Kushtetutës, nenet 6 dhe 8 të KEDNJ-së, neni 1 i protokollit shtesë të KEDNJ-së, nenet 45 dhe 49/2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberin; kërkuesin, që u shpreh për pranimin e kërkesës; subjektet e interesuara, që u shprehën për rrëzimin e saj dhe, pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (ligji objekt shqyrtimi). Qëllimi i këtij ligji, sipas nenit 1, është parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar dhe trafikimit përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të fituar si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale. Këtij ligji i paraprin ligji nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, i cili është shfuqizuar nga ligji objekt shqyrtimi.

2. *Kërkuesi*, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), më 10.2.2010 i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), të ligjit objekt shqyrtimi dhe pezullimin e zbatimit të ligjit deri në përfundim të shqyrtimit të kërkesës nga Gjykata Kushtetuese. Sipas kërkuesit, ligji objekt shqyrtimi bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-ën mbështetur në këto argumente:

- Shprehja “dyshim i arsyeshëm bazuar në indicie”, parashikuar në nenin 3, paragrafi 1 i ligjit, nuk është në përputhje me standardin “dyshim i arsyeshëm”, parashikuar në nenin 27/2 shkronja “c” të Kushtetutës; nenin 5/1 të KEDNJ-së dhe nenin 228/1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Një dyshim i bazuar në indicie nuk mund të jetë i arsyeshëm.

- Ky ligj shkel të drejtën e pronës të sanksionuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i protokollit 1 të KEDNJ-së; ligji i mungojnë garancitë ligjore për një proces të rregullt ligjor, duke cenuar të drejtën e pronës, pasi në mënyrë të paarsyeshme legjitimon hetimin, gjykimin ose vendosjen e masave me karakter pasuror ndaj çdo biznesi ose qytetari; ligji nuk parashikon asnjë kriter ose kusht ligjor që duhet të plotësojë kërkesa e prokurorit për konfiskimin e pasurisë, me qëllim që ajo të jetë e pranueshme dhe e vlerësueshme prej gjykatës.

- Ky ligj shkel të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Neni 12/1 i ligjit shkel të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi parashikon se kërkesa për vendosjen e sekuestros shqyrtohet nga gjykata në praninë e prokurorit, në bazë të dokumenteve të paraqitura prej tij. Pra, ligji mohon të drejtën e aksesit efektiv në gjykatë, bazuar mbi parimin e kontradiktoritetit, barazinë e armëve dhe të drejtën për t’u gjykuar. Neni 21/3 shkel të drejtën e procesit të rregullt ligjor, pasi ndryshon marrëdhënien procedurale dhe sjelljen e palëve në procesin gjyqësor civil, si dhe shkel prezumimin e pafajësisë. Ligji kalon barrën e provës nga organi i prokurorisë te personi ndaj të cilit do të zbatohet masa e konfiskimit. Nenet 10/1, 13 dhe 23/2 të ligjit vijjnë në kundërshtim me thelbin e procesit të rregullt ligjor, ku sanksionohet roli aktiv i gjykatës në proces, duke shkelur kështu parimin e paanshmërisë së gjykatës. Ligji shkel parimin e juridiksionit gjyqësor, pasi në kundërshtim me ndarjen e juridiksionit gjyqësor në gjykatat penale dhe civile, cakton një gjykatë penale të gjykojë një proces civil. Kështu shkelet e drejta e çdo individit që të gjykohej nga një gjykatë kompetente e caktuar me ligj si element i procesit të rregullt ligjor. Neni 3/4 i ligjit bie në kundërshtim me nenin

117 të Kushtetutës i cili parashikon efektin prapaveprues të ligjit edhe për pasuritë e krijuara para hyrjes në fuqi të tij.

- Ky ligj shkel parimin e prezumimit të pafajësisë. Neni 24/2 parashikon se zbatimi i masave me karakter pasuror do të vazhdojë edhe në rastet kur ndaj personit subjekt i ligjit ka pushuar procedimi penal; ai është shpallur i pafajshëm ose ka ndryshuar cilësimi juridik i veprës dhe vepra e re është jashtë fushës së zbatimit të ligjit. Ky nen bie ndesh me vetë qëllimin e ligjit, që synon parandalimin dhe goditjen ndaj krimit të organizuar dhe trafikimit.

- Në nenin 6 të ligjit parashikohet termi “verifikim nga organet e prokurorisë” për të bërë dallimin nga hetimi sipas KPP-së të subjekteve të përmendura në nenin 3, duke shkelur hapur nenet 35, 36, 37 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së, pasi mungojnë garancitë ligjore, që verifikimet të kryhen në përputhje me qëllimin e ligjit. Në ligj nuk janë përcaktuar kritere objektive për përzgjedhjen e subjekteve, duke lënë shteg për trajtim të pabarabartë të shtetasve, në kundërshtim me nenin 18/1 të Kushtetutës (p.sh. rasti i personave me imunitet). Neni 8 i KEDNJ-së në mënyrë eksplicite kërkon përcaktimin e një kufiri në ndërhyrjen e autoritetit shtetëror në cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Neni 6 dhe dispozita të tjera të ligjit nuk parashikojnë kritere dhe as kufizime garantuese që lidhen me procesin e verifikimit.

- Ky ligj është antikushtetues, pasi bie ndesh me parimin e hierarkisë së akteve ligjore të sanksionuar në Kushtetutë. Nenet 8,9,11,12,16,21,23 dhe 38 të ligjit i shtojnë kompetenca të reja organit të prokurorisë që nuk parashikohen as në KPP-së as në ligjin organik të prokurorisë. Ligji shkel nenin 81 të Kushtetutës, sepse parashikon dispozita të veçanta për procedurën që duhet ndjekur në këtë gjykim *sui generis* duke detyruar gjykatën dhe organin e akuzës të zbatojnë rregulla të ndryshme procedurale nga ato të parashikuara në KPP-në dhe Kodin e Procedurës Civile (KPC).

- Ky ligj duhet pezulluar, pasi zbatimi i tij do t'i sjellë pasoja të rënda e të pariparueshme interesave të ligjshëm të shtetasve, duke cenuar të drejtat dhe interesat pasurorë e moralë të individëve ndaj të cilëve do të zbatohet.

3. *Subjekti i interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi)*, parashtron këto prapësime:

- KSHH nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e kësaj kërkesë, pasi objekti i ligjit nuk cenon interesat e anëtarëve të kësaj shoqate. Parashikimi në statutin e kësaj shoqate nuk e legjitimon KSHH-në që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për të konsideruar antikushtetues një ligj, por thjesht e orienton që t'i drejtohet subjekteve kushtetuese propozuese të projektligjeve për të shprehur opinione dhe konsiderata për një projektligj të caktuar.

- Ligji objekt shqyrtimi është në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.

- Pothuajse në të gjitha sistemet juridike të Europës, lufta ndaj krimit të organizuar nuk është bazuar vetëm në konceptin klasik të masës represive, pra vetëm të dënimit. Tashmë, ligjet lidhur me krimin e organizuar, paraqiten në formatin e përqsjes së bazuar në masa represive dhe masa parandaluese.

4. *Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave (KM)* parashtron këto prapësime:

KSHH-ja nuk legjitimohet, pasi sipas nenit 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, organizatat, përfshi KSHH-në bëjnë pjesë në grupin e dytë të subjekteve që ushtrojnë në mënyrë të kufizuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe kanë legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me shkeljen e ndonjë të drejte të KSHH-së, prandaj, për pasojë, nuk ndodhemi përpara ndonjë dëmi real ose potencial.

- Ligji objekt shqyrtimi nuk shkel të drejtën e pronës në kuptim të Kushtetutës dhe nenit 1 protokollit 1 të KEDNJ-së. Pranohet që ligji sjell një kufizim të të drejtave të njeriut, por kufizimi është i ligjshëm, pasi është i vendosur me ligj në përputhje me nenin 17, paragrafi i parë i Kushtetutës. Mbrojtja e interesit publik dhe e të drejtave të të tjerëve është një tjetër kriter i plotësuar nga ligji objekt shqyrtimi. Rrezikshmëria që paraqet krimi i organizuar për një shoqëri të lirë demokratike është botërisht e njohur. Sigurimi i qetësisë së çdo individi, dhe në një koncept më të gjerë, i të gjithë shoqërisë, është detyrë e shtetit dhe një nga detyrat më të rëndësishme të tij, sepse me kryerjen e akteve kriminale të rënda dhunohen jo vetëm të drejtat dhe liritë e njeriut, por edhe vlera të tjera të njohura dhe të mbrojtura nga Kushtetuta. Masat e parashikuara nga ligji janë

proporcionale me gjendjen që e ka diktuar ndërmarrjen e tyre. Krimi i organizuar përbën rrezik për ekzistencën e shtetit dhe të shoqërisë. Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë është një mjet efektiv dhe i nevojshëm për të luftuar krimin e organizuar, i cili është cilësuar si kancer i një shoqërie demokratike. Ligji nuk vendos asnjë pengesë për çdo person që t'i drejtohet gjykatës për të mbrojtur të drejtat e tij.

- Detyrimi për adoptimin e konfiskimit civil të pabazuar në dënimin penal, rrjedh nga akte ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë si; Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të substancave narkotike dhe psikotrope, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit, Konventa e Këshillit të Europës për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e Produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizimit dhe Konventa e Këshillit të Europës për pastrimin, kërkimin, depistimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit.

- Cilësimi i të dhënave dhe fakteve si prova ose indicie nuk ndikon në cenimin e një procesi të rregullt ligjor. Ajo që ka rëndësi për garantimin e një procesi të rregullt ligjor është kushti që vlerësimi i këtyre të dhënave të bëhet në mënyrë të pavarur nga një gjykatë e krijuar me ligj dhe që niveli i këtyre të dhënave të jetë i tillë që të krijojë bindjen e brendshme të gjyqtarit se ekziston dyshimi i arsyeshëm se një person është subjekt i ligjit sipas nenit 3.

- Gjykata civile nuk mund të ketë juridiksion dhe kompetencë për gjykimin e masave parandaluese sipas ligjit objekt shqyrtimi. Ky ligj nuk ka për objekt çështje të së drejtës civile, konflikt mbi marrëdhëniet pasurore e vetjake dhe jo pasurore mes subjekteve të së drejtës civile, pra nuk trajton zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile, administrative ose tregtare ndërmjet tyre, në kuptim të nenit 1 dhe 36 të KPC-së. Procesi civil me natyrë parandaluese vijon në mënyrë autonome, pavarësisht nga ecuria e hetimit paraprak ose shkalla e shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale, sepse nuk është pjesë e fazës së hetimeve paraprake në procedimin penal dhe, për pasojë, nuk është një masë e sigurimit pasuror në zbatim të neneve 270-276 të KPP-së. Procedimi parandalues nuk ka si objekt vërtetimin e fajësisë së personit, por zbatimin e masave parandaluese, me qëllim shmangien e ushtrimit të veprimtarisë kriminale. Për pasojë, pushimi i procedimit penal nuk mund të sjellë efekte në këtë proces civil dhe vijimi i procedimit parandalues në këtë rast nuk cenon parimin e prezumimit të pafajësisë.

- Neni 12 i ligjit nuk shkel parimin e aksesit efektiv në gjykatë. Pjesëmarrja e prokurorit në seancë gjyqësore dhe dokumentet e paraqitura prej tij janë të domosdoshme në një procedurë të tillë, duke qenë se është prokurori që do të paraqesë të dhënat e mjaftueshme, me qëllim që të bindë gjykatën se ekziston dyshimi i arsyeshëm për pjesëmarrje në veprimtari kriminale dhe, për pasojë, jemi përpara rastit ku mund të zbatohen masat parandaluese. Për më tepër, sekuestrimi është masë paraprake dhe personi, pasuria e të cilit preket nga sekuestrimi, ka dy mjete: 1) ankimin dhe 2) gjykimin në themel të konfiskimit.

- Ligji është në harmoni të plotë me nenet 35, 36 dhe 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së.

II

A. Për legjitimitimin e kërkuarit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese sipas objektit të kërkesës

5. Kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e ligjit nr. 10/192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" dhe pezullimin e zbatimit të ligjit deri në përfundim të shqyrtimit të kërkesës nga Gjykata Kushtetuese. Kërkuari parashtron se legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin e këtij ligji në bazë të nenit 134 paragrafi 1/f të Kushtetutës dhe të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, si një organizatë jofitimprurëse, që ka si mision mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të cilat ligji objekt kontrolli kushtetues i cenon. Subjektet e interesuara e kanë kundërshtuar këtë argumentim, duke pretenduar se kërkuari nuk legjitimohet, pasi nuk provon se si ligji në fjalë cenon interesat e anëtarëve të kësaj organizate.

6. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vëren se sipas nenit 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës, organizatat (përfshi KSHH-në) bëjnë pjesë në grupin e dytë të subjekteve që ushtrojnë

në mënyrë të kufizuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Për të treguar që ka legjitimitet, subjekti inicues ka detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet interesit ligjor që ai ka dhe çështjes kushtetuese të ngritur.

7. Gjykata çmon se kuptimi për legjitimitimin duhet parë edhe në këndvështrimin e dallimit që ekziston ndërmjet pretendimeve për cenim të së drejtës së procesit të rregullt ligjor, të drejtës së pronës dhe të së drejtës për mbrojtjen e jetës private nga pretendimi për antikushtetutshmëri të ligjit, në kuptim të rregullimit kushtetues të parashikuar nga nenet 81 dhe 116 të Kushtetutës. Përpara se t'i jepet përgjigje këtyre pretendime, Gjykata vlerëson se, meqenëse gjendemi përpara kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, është e nevojshme të analizohet pretendimi i subjekteve të interesuara për mungesën e legjitimitit të kërkuarit, në kuptim të neneve 17, 35, 41, 42 dhe 81 të Kushtetutës.

8. Gjykata vëren se procedurën e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, në aspektin formal, mund ta vënë në lëvizje, për arsye të një interesi publik, qoftë dhe pa patur një interes konkret subjektiv, vetëm autoritete të larta shtetërore (subjektet e parashikuara nga neni 134 paragrafi 1, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të Kushtetutës). Pra, Kushtetuta legjitimon për të vënë në lëvizje Gjykatën për kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së normës vetëm katër subjektet e para të listuar në nenin 134, paragrafi 1 të Kushtetutës, pasi ky kontroll nuk ushtrohet për një të drejtë subjektive të individit, por për një ballafaqim ndërmjet akteve normative me Kushtetutën. Mbi këtë bazë, të gjitha subjektet e tjera, që parashikohen në nenin 134/1, shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe “g”, i drejtohen Gjykatës në kuptim të kontrollit konkret të kushtetutshmërisë së normës juridike. Në gjykimet e kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, për të legjitimuar subjektet iniciuese, Gjykata Kushtetuese kërkon paraprakisht që ato të provojnë nëse janë subjekte që parashikohen në nenin 134 pika 2 të Kushtetutës dhe nëse çështja kushtetuese e paraqitur për shqyrtim ka lidhje me interesat e tyre. Në plotësim të këtyre kërkesave, Gjykata i konsideron organizatat si subjekte që ushtrojnë të drejtën për një gjykim kushtetues, duke patur legjitimitet vetëm për ato çështje që lidhen me interesat e tyre (*Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 19.3.2008*).

9. Përsa i përket legjitimitit të subjekteve, të cilave u kërkohet interesi i tyre me çështjen, Kushtetuta synon identifikimin e të drejtës së shkelur të subjektit si rrjedhojë e antikushtetutshmërisë në përmbajtje të normës juridike. Pra, interesi konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real ose potencial, dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Gjykata çmon se subjektet e listuara në pikat “dh”, “e”, “ë” dhe “f” të nenit 134/1 mund ta vënë në lëvizje këtë Gjykatë për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit për sa i përket kërkesave të nenit 81 të Kushtetutës, vetëm nëse e përmbushin kushtin e kërkuar nga paragrafi 2, i nenit 134 të Kushtetutës, për të argumentuar “interesin e tyre” në një “çështje të veçantë”. Nga kjo pikëpamje, për çështjen në shqyrtim, Gjykata çmon se është e domosdoshme të analizohet legjitimitimi *ratione materiae* i kërkuarit për pretendimet tij të parashtruara në kërkesë.

10. Sipas statutit të saj, KSHH-ja është një organizatë jofitimprurëse, që ka si mision të vet mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky funksion lidhet edhe me kujdesin për përsosjen e legjislacionit vendas, të dispozitave që garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve. Gjykata vëren se kërkuari ka parashtruar para Gjykatës argumente se si dispozitat e ligjit objekt i këtij kontrolli kushtetues cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat kjo organizatë ka për mision që t'i mbrojë. Ndaj Gjykata arrin në përfundimin se kërkuari legjitimohet si subjekt për të inicuar kontrollin kushtetues të ligjit objekt shqyrtimi lidhur me pretendimet për cenim të të drejtave për një proces të rregullt ligjor, të drejtës së pronës dhe të së drejtës për mbrojtjen e jetës private (*Kundër legjitimitit të kërkuarit votuan anëtarët: V.Kristo, V.Tusha, A.Xhoxhaj*).

11. Për pretendimin se ligji shkel neni 81 të Kushtetutës, pasi nuk është miratuar në përputhje me procedurën dhe me shumicën e kërkuar sipas këtij neni dhe bie në kundërshtim me parimin e hierarkisë së akteve ligjore, Gjykata çmon se, ndonëse kjo dispozitë kushtetuese është më tepër një dispozitë e karakterit procedural, e meta e pretenduar prej kërkuarit është e aspektit material. Pikërisht, parashtrimin e një pretendimi të tillë, që i përket natyrës së një gjykimi abstrakt

të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës juridike prej një subjekti, që e ka të kushtëzuar inicimin e gjykimit kushtetues me të provuarin e interesit për çështjen, Gjykata e çmon të nevojshme ta vlerësojë në drejtim të cenimit ose jo të të drejtave të tjera të pretenduara se cenohen nga ligji objekt kontrolli kushtetues.

B. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit objekt shqyrtimi

12. Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, u vendos rrëzimi i kërkesës. Gjykata nuk gjeti argumente bindëse për mundësinë e cenimit të interesave shtetërore e shoqërore ose të individëve, si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të këtij ligji, në kuptim të kërkesave normative të ligjit.

III

A. Për pretendimin se shprehja “dyshim i arsyeshëm bazuar në indicie”, parashikuar në nenin 3 paragrafi 1 të ligjit, nuk është në përputhje me standardin “dyshim i arsyeshëm”, parashikuar në nenin 27 paragrafi 2 shkronja “c” të Kushtetutës dhe në nenit 5 paragrafi 1 të KEDNJ-së dhe në nenin 228 paragrafi 1 të KPP-së.

13. Kërkuesi pretendon se shprehja “dyshim i arsyeshëm bazuar në indicie shkel nenin 27, paragrafi 2, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenin 5, paragrafi 1 të KEDNJ-së. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, parashtrohet se cilësimi i të dhënave dhe fakteve, si prova ose indicie, nuk ndikon në cenimin e një procesi të rregullt ligjor, pasi sipas tij, ajo që ka rëndësi për garantimin e një procesi të rregullt ligjor është vlerësimi i këtyre të dhënave në mënyrë të pavarur nga një gjykatë e krijuar me ligj dhe që niveli i këtyre të dhënave të jetë i tillë që të krijojë bindjen e brendshme të gjyqtarit se ekziston dyshimi i arsyeshëm se një person është subjekt i ligjit sipas nenit 3 të tij.

14. Gjykata vëren se neni 3 i ligjit, objekt kontrolli kushtetues, parashikon se dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie: a) për pjesëmarrje në organizata kriminale ose në grupe të strukturuar kriminale, sipas parashikimeve të neneve 333 dhe 333/a të Kodit Penal (KP) dhe për kryerje të krimeve prej tyre; b) për pjesëmarrje në organizata terroriste ose në banda të armatosura, sipas parashikimeve të neneve 234/a dhe 234/b të KP-së dhe për kryerje të krimeve prej tyre; c) për kryerjen e veprave të tjera, për qëllime terroriste, të parashikuara në pjesën e posaçme kreu VII i KP-së; ç) për kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109¹, 109/b², 110/a³, 114/b⁴, 128/b⁵, 278/a⁶, 282/a⁷, 283⁸, 283/a⁹ dhe 284/a¹⁰ të KP-së; d) për kryerjen e krimeve për qëllime të fitimit të pasurive të paligjshme, të parashikuara në nenet 114/a¹¹ dhe 287¹² të KP-së.

15. Neni 27, paragrafi 2 i Kushtetutës parashikon se “Liria e personit nuk mund të kufizohet përveçse në rastet e mëposhtme...kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj”. Ndërsa neni 228, paragrafi 1 i KPP-së referuar nga kërkuesi parashikon se “askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal, nëse në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm bazuar në prova.”

¹ Neni 109 : Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit

² Neni 109/b: Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë

³ Neni 110/a: Trafikimi i personave

⁴ Neni 114/b: Trafikimi i femrave

⁵ Neni 128/b: Trafikimi i të miturve

⁶ Neni 278/a: Trafikimi i armëve dhe i municionit

⁷ Neni 282/a: Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive

⁸ Neni 283: Prodhimi dhe shitja e narkotikëve

⁹ Neni 283/a: Trafikimi i narkotikëve

¹⁰ Neni 284/a: Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale

¹¹ Neni 114/a: Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese

¹² Neni 287: Pastrimi i produkteve të veprës penale

16. Gjykata vlerëson se neni 27 paragrafi 2 i Kushtetutës mbi kriterin e dyshimit të arsyeshëm lidhet me garancitë kushtetuese për privimin e lirisë. Ndërsa ligji objekt shqyrtimi, në nenin 1 për objektin e ligjit, parashikon se: “Ky ligj përcakton procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave, që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe trafikim”. Neni 4 i ligjit saktëson se masë parandaluese është çdo masë me karakter pasuror, që gjykata vendos në një procedim gjyqësor, nëpërmjet sekuestrimit të pasurive, veprimtarisë ekonomike, tregtare dhe profesionale të personave, si dhe nëpërmjet konfiskimit të tyre. Ndaj garancia e cituar kushtetuese nuk ka lidhje me objektin e ligjit dhe, për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se ligji nuk shkel nenin 27, paragrafi 2 shkronja “c” të Kushtetutës dhe pretendimi i kërkuarit është i pabazuar.

B. Për pretendimin se ligji objekt shqyrtimi cenon të drejtën e pronës, të sanksionuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1, protokollin 1 i KEDNJ-së

17. Kërkuari pretendon se ligji përmes masave parandaluese cenon të drejtën e pronës të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i protokollit 1 të KEDNJ-së; ligji i mungojnë garancitë ligjore për një proces të rregullt ligjor, duke cenuar të drejtën e pronës, pasi në mënyrë të paarsyeshme legjitimon hetimin, gjykimin ose vendosjen e masave me karakter pasuror ndaj çdo biznesi ose qytetari; ligji nuk parashikon asnjë kriter ose kusht ligjor që duhet të plotësojë kërkesa e prokurorit për konfiskimin e pasurisë, me qëllim që kjo kërkesë të jetë e pranueshme dhe e vlerësueshme prej gjykatës; konfiskimi, pa zbatuar më parë sekuestrimin, cenon të drejtën e procesit të rregullt ligjor, pasi cenon të drejtën e pronës, e cila nuk ka qenë objekt shqyrtimi gjyqësor; ligji nuk parashikon mundësinë e shpërblimit në rastet e sekuestrimeve ose konfiskimeve të padrejta. Subjektet e interesuara e kundërshtojnë këtë pretendim, duke theksuar se, ndonëse ligji përbën kufizime, ai është në përputhje me standardet e nenit 17 të Kushtetutës për kufizimet e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të së drejtës së pronës.

18. Gjykata vëren se ligji objekt shqyrtimi lidhet me zbatimin e një regjimi juridik të posaçëm për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive që burojnë ose lidhen me disa nga dukuritë më të rënda kriminale, me një lloj procedimi të posaçëm të natyrës parandaluese dhe goditëse ndaj këtyre dukurive. Në thelb, ligji parashikon dy lloj masash parandaluese, të cilat janë sekuestrimi dhe konfiskimi. Neni 11 i ligjit cakton kriteret për sekuestrim të pasurisë, duke parashikuar: “Me kërkesë të motivuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive të personave, sipas nenit 3 të këtij ligji, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie që tregojnë se personi mund të jetë i përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre dhe kur: a) ekziston një rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji ose b) ka dyshime të arsyeshme që tregojnë se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive të caktuara ekonomike, tregtare dhe profesionale janë në gjendje rreziku apo ndikimi nga ana e një organizate kriminale ose që mund të lehtësojnë veprimtaritë kriminale. Kërkesa e prokurorit për sekuestrimin e pasurisë përmban indiciet, në të cilat bazohet dyshimi i arsyeshëm, si dhe arsyetimin për të paktën një prej kushteve të pikës 1 të këtij neni.” Konfiskimi rregullohet nga nenet 21-25 të ligjit.

19. Gjykata vlerëson se masat parandaluese, të parashikuara në ligj, cenojnë të drejtën e pronës, por çështja që shtrohet është nëse kufizimet janë të nevojshme, pra bëhen për një interes publik dhe janë në përputhje me gjendjen që ka diktuar marrjen e këtyre masave. Neni 17/1 i Kushtetutës, kërkesat e të cilit shtrihet ndaj të gjitha të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë, parashikon se “kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përputhje me gjendjen që e ka diktuar atë”.

20. Gjykata ka sqaruar se parimi i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësive për kufizimin e një të drejte ose lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 19.3.2008*). Në këtë mënyrë, pajtueshmëria e masës kufizuese të marrë nga ligjvënësi me ekzistencën e nevojës së kufizimit duhet të verifikohet në aspektin e kushteve të vendosura në dispozitat e sipërpërmendura të

nenit 17 të Kushtetutës dhe konkretisht të ekzistencës së “interesit publik”. Një kusht tjetër që duhet të respektojë ligjvënësi në vendosjen e kufizimit është që ky kufizim të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Ky kusht e imponon ligjvënësin të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në të drejtat individuale në një situatë konkrete. Baraspeshimi i ndërhyrjes, me gjendjen që e ka diktuar ndërhyrjen, imponon ligjvënësin të zbatojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, d.m.th. të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Përveç kësaj, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, çka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë, gjithashtu, edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar, konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, të dobishmërisë dhe proporcionalitetit, në kuptimin strikt të kufizimeve të imponuara. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton kufizimin me ato të drejta që i nënshtrohen kufizimit, si dhe duke vlerësuar edhe mënyrën e kufizimit. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese thekson se respektimi i përmbushjes së kushteve të mësipërme të kufizimit kërkon një trajtim të diferencuar (një farë relativiteti), në varësi të të drejtave dhe lirive individuale që i nënshtrohen kufizimit (*Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 16/2008*).

21. Koncepti kushtetues i interesit publik, ashtu siç është trajtuar tashmë në disa raste nga Gjykata Kushtetuese, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e dispozitës konkrete që paraqitet për kontroll para saj. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese rastet e interesit publik ose të arsyes publike që të çojnë në kufizimin e një të drejte themelore. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit konkret. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 10 12.03.2008*).

22. Në zbatim të kriterëve të mësipërme kushtetuese dhe jurisprudencës së saj, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kufizimet e të drejtës së pronës dhe të veprimtarisë ekonomike janë vendosur për t'i shërbyer një interesi publik që është parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar dhe trafikimit përmes sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të personave të dyshuar për pjesëmarrje në organizata kriminale, pjesëmarrje në organizata terroriste e banda të armatosura e trafikime. Nëpërmjet ngrirjes dhe konfiskimit të pasurive, ligji synon parandalimin e kryerjes së veprimtarive kriminale.

23. Dallimi ndërmjet këtyre dy masave parandaluese nuk qëndron në faktin se njëra masë duhet detyrimisht të paraprijë masën tjetër. Sekuestrimi ka si tipare të tij urgjencën e ndërhyrjes (gjykata vendos brenda 5 ditëve), si dhe përkohshmërinë e zbatimit të masës, pra heqjen e të drejtës së administrimit të pronës për një periudhë të caktuar kohore. Nga ana tjetër, konfiskimi ka si tipare të tij verifikimin më të thelluar të kërkesës nga ana e gjykatës, si dhe kalimin përfundimtar të pasurisë në favor të shtetit. Në rast se prokurori çmon se nuk ekziston rreziku për humbje, marrje ose tjetërsim të pasurisë ose rreziku i përdorimit të pasurisë për lehtësimin e veprimtarisë kriminale, gjatë kohës prej 3 muajve që i nevojitet gjykatës për shqyrtimin e kërkesës për konfiskim (pra nuk jemi përpara kushteve të urgjencës për heqjen e së drejtës për administrimin e pasurisë), prokurori mund të paraqesë kërkesë për konfiskim pa kërkuar fillimisht zbatimin e masës së sekuestrimit.

24. Masa e konfiskimit merret vetëm pas një shqyrtimi të thelluar gjyqësor që kryhet nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Një fakt i tillë rezulton qartë nga përmbajtja e nenit 23 të ligjit objekt shqyrtimi, ku përcaktohet se gjykata, brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës së prokurorit, vendos mbi kërkesën për konfiskimin e pasurisë. Në raste komplekse gjykatës i njihet e drejta që edhe kryesisht të vendosë që të japë vendimin e saj në një afat të mëvonshëm, por brenda një viti nga data e paraqitjes së kërkesës për konfiskim. Në çdo rast vendimi i gjykatës merret pas një procesi gjyqësor, ku shqyrtohen si kërkesa e prokurorit për konfiskim, edhe pretendimet e personit. Në këtë kuadër, mbrojtja e pronës është objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe zbatimi i masës së konfiskimit merret vetëm pasi gjykata verifikon përmbushjen e kushteve të vendosura në nenin 24 të ligjit.

25. Gjykata vlerëson se edhe parashikimi në nenin 29/3, për zhdëmtimin respekton parimin e proporcionalitetit të kufizimit. Kështu, ky nen parashikon se zotëruesi i pasurisë ka të drejtë të kërkojë zhdëmtim të drejtë, nëse në vijim provohet paligjshmëria ose pabazueshmëria e konfiskimit. Pra, Gjykata arrin në përfundimin se masat parandaluese, të parashikuara në ligj, i shërbejnë një interesi publik dhe janë në përpjesëtim me gjendjen që e kanë diktuar atë. Ligji parashikon garanci të tilla procedurale, në mënyrë që të arrihet një balancë e drejtë ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe interesave të individit ose individëve në fjalë.

26. Analiza dhe qëndrimi i mësipërm i kësaj Gjykate gjen mbështetje edhe nga jurisprudenca përkatëse e Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Kjo e fundit, për masën e sekuestrimit të Aktit Italian të vitit 1965, është shprehur se kjo masë nuk ka për qëllim që të privojë kërkuesin nga prona e tij, por vetëm e ndalon atë që ta përdorë; sekuestrimi është qartazi një masë që ka për qëllim të sigurojë që pasuria, e cila duket se është fryt i veprimtarive të paligjshme të kryera në dëm të bashkësisë, të mund të konfiskohet më tej, nëse është e nevojshme; masa si e tillë është e justifikueshme nga interesi i përgjithshëm dhe, duke pasur parasysh fuqinë e rrezikshme ekonomike të një organizate si Mafia, nuk mund të thuhet se marrja e saj në këtë fazë të procedimit është disproporcionale me qëllimin që synohet të arrihet (*Shih çështjen Raimonondo v. Italisë, vendimi i GJEDNJ-së i 22 shkurt 1994, para.27*). Për konfiskimin, në këtë çështje GJEDNJ-ja ka pranuar se konfiskimi përbën një privim të pronës. Sipas saj, konfiskimi ka synuar të ndjekë një qëllim, që ishte në interesin e përgjithshëm, pra kërkonte të siguronte se përdorimi i pronës në fjalë nuk do të sillte fitime për kërkuesin ose organizatën kriminale, anëtar i së cilës ai dyshohej se ishte, në dëm të bashkësisë. GJEDNJ-ja i njeht një hapësirë të gjerë vlerësimi shtetit italian. Ajo shprehet, ndër të tjera, se konfiskimi, i cili është hartuar për të bllokuar lëvizjen e kapitaleve të dyshimta, është një armë efektive dhe e nevojshme në luftën kundër krimit të organizuar dhe Mafies. Prandaj duket proporcionale me qëllimin që synon të arrihet. (*Shih çështjen Raimondo të GJEDNJ-së paragrafi 30*). Në çështjen *Agosi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të 24 tetor 1986, GJEDNJ-ja, ndër të tjera, shprehet se paragrafi 2 i nenit 1, protokollit 1 të KEDNJ-së i njeht të drejtën shteteve të miratojnë ato ligje që i konsiderojnë të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm. Por duhet të ekzistojë një marrëdhënie proporcionaliteti ndërmjet masës së marrë dhe qëllimit që synohet të arrihet; me fjalë të tjera, duhet të shqyrtohet nëse ka një balancë të drejtë ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe interesave të individit ose individëve në fjalë. Në përcaktimin e kësaj baraspeshe, GJEDNJ-ja njeht që shteti gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi si për zgjedhjen e mjeteve, ashtu edhe në përcaktimin e pasojave të masës, të cilat justifikohen nga interesi i përgjithshëm për qëllim të arritjes së qëllimit të ligjit në fjalë. Në çështjen *Arcuri dhe të tjerë kundër Italisë* i 5 korrik 2001, GJEDNJ-ja vendosi se edhe pse masa në fjalë sillte privimin e pronës, kjo përbente një kontroll të përdorimit të pronës në kuptim të paragrafit të dytë të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së, i cili u jep të drejtën shteteve që të miratojnë ligje që i konsiderojnë të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm. Ajo ka theksuar edhe se masa e kundërshtuar bën pjesë në një politikë për parandalimin e krimit. GJEDNJ-ja shprehet se konfiskimi në këtë rast ka synuar të parandalonte përdorimin e paligjshëm, në një mënyrë të rrezikshme për shoqërinë, të zotërimeve, origjina e ligjshme e të cilave nuk është vërtetuar. Qëllimi i kësaj ndërhyrjeje, sipas saj, i shërben interesit publik dhe është në përpjesëtim me qëllimin legjitim që synon të arrijë.

27. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kufizimi i të drejtës së pronës, i garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1, protokollit 1 i KEDNJ-së, nga ligji objekt shqyrtimi, nuk bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës dhe, për këtë arsye, pretendimi i kërkuesit është i pambështetur.

C. Për pretendimet se ligji objekt shqyrtimi shkel disa elemente të procesit të rregullt ligjor të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së

28. Kërkuesi pretendon se ligji cenon një sërë elementesh të procesit të rregullt ligjor. Më konkretisht kërkuesi pretendon: Neni 12, paragrafi 1 i ligjit mohon të drejtën e aksesit efektiv në gjykatë, bazuar mbi parimin e kontradiktoritetit, barazinë e armëve dhe të drejtën për t'u gjykuar, pasi parashikon se kërkesa për vendosjen e sekuestratos shqyrtohet nga gjykata në praninë e prokurorit, në bazë të dokumenteve të paraqitura prej tij; ky ligj nuk parashikon asnjë kriter ose

kusht ligjor që duhet të plotësojë kërkesa e prokurorit për konfiskimin e pasurisë, me qëllim që kjo kërkesë të jetë e vlerësueshme dhe pranueshme prej gjykatës; neni 21, paragrafi 3 shkel të drejtën e procesit të rregullt ligjor, pasi ndryshon marrëdhënien procedurale dhe sjelljen e palëve në procesin gjyqësor civil, si dhe shkel prezumimin e pafajësisë dhe se kështu bëhet kalimi i barrës së provës nga organi i prokurorisë te personi ndaj të cilit do të zbatohet masa e konfiskimit; neni 10, paragrafi 1, neni 13 dhe 23, paragrafi 2 të ligjit, ku parashikohet roli aktiv i gjykatës në proces, vijnë në kundërshtim me thelbin e procesit të rregullt ligjor, duke shkelur kështu parimin e paanshmërisë së gjykatës; ligji shkel parimin e juridiksionit gjyqësor, pasi në kundërshtim me ndarjen e juridiksionit gjyqësor në gjykata penale dhe civile, cakton një gjykatë penale të gjykojë një proces civil. Kështu shkelet e drejta e çdo individi që të gjykohej nga një gjykatë kompetente e caktuar me ligj, si element i procesit të rregullt ligjor. Subjektet e interesuara i prapësojnë këto pretendime duke pretenduar se ndonëse ligji kufizon të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, ai është në përputhje me Kushtetutën se bëhet për një qëllim të ligjshëm dhe ky kufizim është bërë duke respektuar kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës.

29. Gjykata vëren se nenet e sipërcituara të ligjit parashikojnë:

- Neni 12, paragrafi 1 i ligjit parashikon : *“Kërkesa për sekuestrimin e pasurisë shqyrtohet nga gjykata, me pjesëmarrjen e prokurorit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes, në bazë të dokumenteve të paraqitura prej tij.”*

- Neni 21, paragrafi 3: *“Barra e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi.”*

- Neni 10, paragrafi 1: *“Gjykata, me kërkesë të palëve ose kryesisht, mund të kryejë veprime të tjera të posaçme, që nuk rregullohen shprehimisht me ligj, nëse ato vlejnë për zgjidhjen e çështjes dhe nuk prekin thelbin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.”*

- Neni 13, paragrafi 1: *“Me vendimin e revokimit të masës së sekuestrimit, gjykata mund të vendosë detyrimin ndaj pronarit të pasurisë apo personit që ka në përdorim ose administrim pasurinë, apo pjesë të saj, për të njoftuar, për një periudhë jo më pak se 5 vjet, në Policinë Tatimore, akte të zotërimit, blerjes ose pagesave të kryera, të pagesave të marra, detyrave profesionale, të administrimit ose kujdestarisë, si dhe akte apo kontrata të tjera, sipas llojit dhe vlerës së përcaktuar nga gjykata, në varësi të pasurisë dhe të të ardhurave të personit, por jo për një vlerë më të vogël se 2 milionë lekë.”*

- Neni 13, paragrafi 2: *“Njoftimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni bëhen brenda 10 ditëve nga përfundimi i aktit dhe, në çdo rast, brenda datës 31 janar të çdo viti, për aktet e kryera në vitin pararendës.”*

- Neni 13, paragrafi 3: *“Personit që nuk respekton detyrimet e njoftimit, brenda afateve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, i konfiskohen, tërësisht ose pjesërisht, sendet e fituara dhe pagesat e marra, për të cilat nuk është respektuar detyrimi i njoftimit.”*

- Neni 23, paragrafi 2: *“Konfiskimi i pasurisë kërkohet dhe vendoset edhe në raste kur ndaj pasurive nuk është kërkuar dhe vendosur masa e sekuestrimit.”*

30. Gjykata, në vijim vlerëson me radhë pretendimet për shkelje të elementeve të procesit të rregullt ligjor.

C.1. Për pretendimin se ligji objekt shqyrtimi cenon të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit)

31. Kërkuesi pretendon se neni 12, paragrafi 1 i ligjit shkel hapur të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi parashikon se kërkesa për vendosjen e sekuestrimit shqyrtohet nga gjykata në praninë e prokurorit, në bazë të dokumenteve të paraqitura prej tij. Kështu, sipas kërkuesit, ligji mohon të drejtën e aksesit efektiv në gjykatë, bazuar mbi parimin e kontradiktoritetit, barazinë e armëve dhe të drejtën për t’u gjykuar. Ligji nuk parashikon asnjë kriter ose kusht ligjor që duhet të plotësojë kërkesa e prokurorit për konfiskimin e pasurisë, me qëllim që kjo kërkesë të jetë e vlerësueshme dhe pranueshme prej gjykatës.

32. Gjykata vëren se neni 42, paragrafi 2 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Gjykata ka vlerësuar edhe më parë se

“Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*Shih vendimet e GJK nr.14 datë 3.6.2009 dhe nr. 7 datë 11.3.2008*). Neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ sanksionojnë në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t’iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t’ia garantojë atij këtë akses (*Shih vendimet e GJK nr. 5 datë 6.3.2009 dhe nr. 17, datë 19.06.2009*). E drejta e aksesit në gjykatë mund t’i nënshtrohet kufizimeve deri në atë masë sa ato të mos cenojnë thelbin e kësaj të drejte. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës (*Vendimi i GJK nr. 18, datë 8.7.2009*). Gjykata vëren se neni 33 i Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet. Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit kërkon që secilës palë në gjykim t’i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur pretendimet e veta sipas kushteve, të cilat nuk e vendosin në dizavantazh ndaj kundërshtarit. Secila palë duhet të ketë mundësi që të komentojë mbi të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës.

33. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se në dukje neni 12, paragrafi 1 i ligjit objekt shqyrtimi nuk parashikon shprehimisht mundësinë e personit subjekt i nenit 3 të ligjit që të paraqesë para gjykatës qëndrimet e parashtrimet e veta për kërkesën e prokurorit për sekuestrim. Por neni 27 parashikon procedurën e ankimit, sipas të cilit kundër vendimit të gjykatës për sekuestrimin e pasurisë, zgjatjen e afatit të masës së sekuestrimit, revokimit ose të shuarjes së masës së sekuestrimit, mund të bëhet ankim në gjykatën e një niveli më të lartë, sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në KPC. Ankimi, sipas pikës 1 ose 2 të nenit 27, nuk pezullon zbatimin e vendimit, përveçse kur ligji parashikon ndryshe. Pra, gjatë gjykimit për sekuestrimin e pasurisë në shkallë të parë, personi, pasuria e të cilit sekuestron, nuk ka formalisht një mjet efektiv për të ndikuar gjykatën në këtë fazë. Megjithatë, duke qënë se e drejta e ankimit parashikohet shprehimisht në nenin 27 të ligjit, Gjykata çmon se procesi në tërësinë e tij i jep mundësinë personit të prekur që të vërë në vend të drejtën e tij, p.sh. në rast se gjykata e apelit do të arrinte në përfundimin se pretendimi është i bazuar do të vendoste heqjen e sekuestrimit. Prandaj i parë në tërësinë e vet, Gjykata arrin në përfundimin se procesi për vendosjen e masës së sekuestrimit nuk cenon standardin kushtetues të aksesit efektiv në gjykatë, kontradiktoritetit dhe të drejtës për t’u dëgjuar.

34. Për pretendimin e kërkuar se ligji nuk parashikon asnjë kriter apo kusht ligjor që duhet të plotësojë kërkesa e prokurorit për konfiskimin e pasurisë, me qëllim që ajo të jetë e pranueshme dhe e vlerësueshme prej gjykatës, Gjykata, së pari vlerëson se kërkuar nuk ka argumentuar para saj në mënyrë të qartë se me cilin element të procesit të rregullt lidhet ky pretendim. Megjithatë, Gjykata e analizon këtë pretendim, që lidhet me nenin 21 të ligjit, në dritën e parimit të kontradiktoritetit. Gjykata vëren se neni 21 për kriteret për konfiskim të pasurisë dhe barrën e provës shprehet se masa e konfiskimit vendoset me kërkesë të prokurorit, i cili i paraqet gjykatës arsyet ku bazohet kërkesa. Barra e provës më pas i kalon personit, i cili duhet të vërtetojë që pasuria është fituar në mënyrë të ligjshme. Neni 22 sqaron me hollësi procedurën e konfiskimit. Pra, është mëse e qartë që para gjykatës zhvillohet një proces gjyqësor, ku palët shprehin argumentet e tyre dhe kanë mundësi të debatojnë, për të ndikuar vendimmarrjen gjyqësore. Vendimi i gjykatës, përveç elementeve të parashikuara në nenin 310 të KPC-së, sipas të cilit vendimi duhet të përmbajë hyrjen, pjesën arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, ku pjesa arsyetuese duhet të përmendë rrethanat e çështjes ashtu siç janë vërejtur nga gjykata gjatë gjykimit, provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi, duhet të përmbajë edhe: a) llojin e masës parandaluese dhe kohëzgjatjen e saj, nëse masa është caktuar me afat; b) llojin e pasurisë me të gjitha të dhënat që shërbejnë për identifikimin e saj, përfshirë edhe vendndodhjen ose çdo gjë tjetër që vlen për ta identifikuar atë; c) parashtrimin e përmbledhur të faktit dhe shkakun ligjor të masës parandaluese; ç) masën e shpenzimeve procedurale, llojin e tyre, si dhe të dhëna për personin, të cilit i ngarkohen ato. Gjykata çmon se

këtë vendimmarrje gjykatat e zakonshme nuk mund ta arrijnë pa kryer një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në përputhje me ligjin dhe duke lejuar një debat të plotë gjyqësor. Prandaj Gjykata arrin në përfundimin se edhe ky pretendim i kërkuetit është i pambështetur.

C.2 Për pretendimin se cenohet prezumimi i pafajësisë

35. Kërkueti pretendon se ligji shkel parimin e prezumimit të pafajësisë, duke kaluar barrën e provës te personi, ndaj pasurisë së të cilit janë marrë masat parandaluese.

36. Gjykata fillimisht sqaron përmbajtjen e prezumimit të pafajësisë sipas Kushtetutës, si edhe lidhjen e këtij parimi me barrën e provës. Kushtetuta parashikon se kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë (neni 30 i Kushtetutës). Gjykata është shprehur më parë se prezumimi i pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 28.4.2004; nr. 23 datë 23.7.2009*).

37. Por Gjykata saktëson se ky interpretim i nenit 30 të Kushtetutës lidhet ngushtësisht me proceset penale. Procedimi i parashikuar në këtë ligj është një procedim i veçantë autonom nga procesi penal, ndaj garancitë e procesit penal nuk mund të gjejnë zbatim në këtë proces të rregulluar nga ligji objekt shqyrtimi. Siç e konfirmon edhe neni 5, paragrafi 1, ky ligj rregullon marrëdhënien ndërmjet procedurës së caktimit të masave parandaluese dhe procedimit penal, duke vendosur se “procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij ligji”.

38. Gjykata, në ligjin objekt shqyrtimi vlerëson se, veçanërisht formulimet e nenit 11, paragrafi 1 (kriteret për sekuestrim), ku parashikohet se prokurori bën kërkesë të motivuar, dhe nenit 21 (kërkesa për konfiskim dhe barra e provës), ku prokurori përsëri duhet t’i paraqesë gjykatës arsyet ku bazohet kërkesa, barra e provës fillimisht i takon prokurorit për të argumentuar dyshimin e arsyeshëm bazuar në indicie, se një person është pjesëmarrës në krimin e organizuar dhe trafikim sipas veprave të parashikuara në nenin 3. Mbështetur në verifikimet e kryera, prokurori ka detyrimin për të parashtruar kërkime të motivuara dhe të dhëna mbështetëse përpara gjykatës për identifikimin e pasurive të personit të dyshuar dhe të personave të tjerë; të tregojë nga ana e tij se ka baza për dyshim të arsyeshëm dhe të dhëna të mjaftueshme për efekt të gjykimit parandalues, se ato nuk janë pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, çka motivon ekzistencën e prezumimit të paligjshmërisë së tyre, dhe si rezultat, kalimin e barrës së provës personit të dyshuar. Pas kësaj, barra e provës kalon te personi i dyshuar, për të justifikuar origjinën e ligjshme të pasurive të tij, për të argumentuar mungesën e lidhjes së pasurisë me cilësimin si produkte të veprave penale ose investim të tyre. Më pas është detyrë e gjykatës që të sigurojë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të kryejë një hetim të gjithanshëm dhe të plotë, për dhënien e një vendimi të drejtë dhe të mbështetur në ligj. Pra, në dallim nga procedimi penal, gjykimi parandalues mbështetet në dyshimin e arsyeshëm bazuar në indicie, duke iu ngarkuar barra e provës personit të dyshuar dhe personave të tjerë, për të vërtetuar ligjshmërinë, për justifikimin e origjinës së pasurisë. Pra, në këtë proces, barra e provës është e ndarë ndërmjet prokurorit dhe personit të cilit do t’i sekuestrohet ose konfiskohet pasuria. Në vijim të këtyre arsyetimeve dhe argumenteve për nevojën e dallimit ndërmjet procesit penal dhe procesit parandalues, garancitë e procesit penal për prezumimin e pafajësisë nuk janë të zbatueshme në procesin parandalues, të sanksionuar nga ligji objekt shqyrtimi.

39. Gjykata vëren se këtë dallim ndërmjet procesit penal dhe procesit të masave parandaluese, dhe zbatimin e garancive të procesit penal në procedimin e masave parandaluese e vë në dukje edhe Gjykata Kushtetuese Italiane, kur shprehet për kushtetueshmërinë e ligjit italian të vitit 1956 (për masat parandaluese ndaj pasurive të krimit të organizuar). Gjykata Kushtetuese Italiane,

me vendimin nr. 27 të vitit 1959 dhe vendimin nr. 23 të vitit 1964, ka mbajtur këtë qëndrim: “...në sistemin ligjor italian ka një dallim thelbësor ndërmjet dënimeve penale dhe masave parandaluese. Të parat përbëjnë një përgjigje ndaj akteve të paligjshme dhe pasojat që sjell ai veprim; të dytat janë mjet për parandalimin e kryerjes së një veprimi të tillë. Me fjalë të tjera një dënim penal lidhet me një vepër penale të kryer, ndërsa masat parandaluese synojnë të reduktojnë rrezikun e veprave të ardhshme.

Meqenëse sanksionet penale dhe masat parandaluese janë në thelb të ndryshme, jo të gjitha parimet kushtetuese që qëndrojnë në themel të sistemit penal, zbatohen ndaj tjetrit. Për shembull, prezumimi i pafajësisë nuk lidhet me masat parandaluese, pasi ato nuk bazohen në përgjegjësinë penale ose në fajin e personit” (përkthim i GjK) (Shih vendimi i Gjykatës Kushtetuese Italiane të vitit 1964).

C.3. Për pretendimin se ligji cenon parimin e gjykatës të caktuar me ligj

40. Kërkuesi kundërshton gjykimin e çështjeve objekt i këtij ligji nga Gjykata e Krimeve të Rënda, duke theksuar që ligji shkel parimin e ndarjes së juridiksionit civil dhe atij penal dhe për rrjedhojë, elementin e procesit të rregullt të gjyimit nga një gjykatë kompetente e caktuar me ligj.

41. Gjykata vëren se ligji objekt shqyrtimi, në nenin 7, ka parashikuar si gjykatë kompetente për marrjen e masave parandaluese në shkallë të parë Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda dhe në shkallë të dytë Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda.

42. Gjykata ka theksuar edhe më parë se shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj” është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Termi “gjykatë” karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit (Shih vendimet nr.7, datë 9.3.2009; nr.31, datë 1.12.2005; nr.23, datë 23.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese).

43. Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka dhënë argumente bindëse që do të vinin në dyshim plotësimin e kërkesave të mësipërme që imponon standardi i “gjykatës së caktuar me ligj” nga Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda dhe në shkallë të dytë nga Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda. Prandaj Gjykata çmon se pretendimi i kërkuetit është i papabuar.

Ç. Për pretendimin se cenohet e drejta e ruajtjes së jetës private, garantuar nga nenet 35, 36 dhe 37 të Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ-së

44. Kërkuesi pretendon se neni 6 i ligjit objekt shqyrtimi shkel hapur nenet 35, 36, 37 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së, pasi mungojnë garancitë ligjore që verifikimet të kryhen në përputhje me qëllimin e ligjit; nuk janë përcaktuar kriteret objektive për përzgjedhjen e subjekteve, duke lënë shteg për trajtim të pabarabartë të shtetasve, në kundërshtim me nenin 18/1 të Kushtetutës (p.sh. rasti i personave me imunitet); neni 8 i KEDNJ-së në mënyrë eksplicite kërkon përcaktimin e një kufiri në ndërhyrjen e autoritetit shtetëror në cenimin e së drejtës për ruajtjen e jetës private.

45. Në ligjin objekt shqyrtimi parashikohet: “1. Ndaj personave të parashikuar në nenin 3 të këtij ligji kryhen verifikime për mjetet financiare, pasuritë, veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale, nivelin ekonomik, si dhe për burimet e të ardhurave të tyre. 2. Verifikimet bëhen, në veçanti, nëse këta persona janë zotërues të lejeve, licencave, autorizimeve, koncesioneve dhe të drejtave të tjera për të ushtruar veprimtari ekonomike, tregtare dhe profesionale, si dhe për të verifikuar nëse ata përfitojnë kontribute, financime ose kreditime të çdo lloji, të dhëna apo të përfituara nga shteti, ente a persona juridikë publikë, organizma ose institucione ndërkombëtare, si dhe për të verifikuar nëse pasuritë, veprimtaritë apo të drejtat pasurore janë të përligjura.”

46. Gjykata vëren se neni 6 i ligjit përbën një ndërhyrje në të drejtën e mbrojtur nga neni 37 i Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ-së. Çështja që shtrohet është nëse kjo ndërhyrje është e justifikueshme sipas nenit 17 të Kushtetutës dhe nenit 8, paragrafi 2 i KEDNJ-së, pra nëse ajo është “në përputhje me ligjin” ose “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për një nga qëllimet e parashikuara. Ligji, këtë proces verifikimi, e lidh me ata persona që bien në fushën e veprimit të nenit 3, pra për të cilët ka një dyshim të arsyeshëm bazuar në indicie për pjesëmarrje në organizata kriminale, terroriste etj. Ligji ka përcaktuar në mënyrë të qartë fushën e zbatimit, si dhe personat që

janë subjekt të dispozitave të tij. Fusha e zbatimit të ligjit është e kufizuar vetëm për personat për të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm për pjesëmarrjen e tyre në veprimtari kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Për rrjedhojë, jo çdo subjekt në Shqipëri është i ekspozuar në verifikimet e organit të akuzës. Në rastin e verifikimit, sipas dispozitave të ligjit objekt shqyrtimi, është prokurori që, pas marrjes dijeni për pasuritë që duhen verifikuar, kryen hetimet përkatëse.

47. Gjykata Kushtetuese thekson se parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar është një nga detyrat themelore të shtetit, me qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe të drejtave e lirive themelore të njeriut. Për pasojë është e domosdoshme që të merren masa për verifikimin e të dhënave edhe pa pëlqimin e personit, për subjekte për të cilat ekziston dyshimi i arsyeshëm, bazuar në indicie për kryerjen e veprimeve kriminale, me qëllim parandalimin e krimit të organizuar dhe goditjen e një prej mjeteve kryesore që e mbështet këtë veprimtari.

48. Neni 8 i KEDNJ-së sanksionon të drejtën e çdokujt që t'i respektohet jeta private, përveç në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur, në një shoqëri demokratike, ndërhyrja në ushtrimin e kësaj të drejte është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurinë publike, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Pra, siguria publike, parandalimi i veprave penale, si dhe mbrojtja e të drejtave të të tjerëve shërbejnë si premisa për të konsideruar, në përputhje me këtë Konventë, një ndërhyrje në të drejtën për jetë private. Pra, në bazë të argumenteve dhe interpretimit të mësipërm, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuesit nuk është i mbështetur.

D. Për pretendimin se ligji shkel hierarkinë e akteve normative dhe se është miratuar jo sipas kërkesave të nenin 81 të Kushtetutës

49. Gjykata çmon se, përderisa nuk vëren cenim të të drejtave të njeriut në kuptimin kushtetues, të pretenduara nga kërkuesi, nuk mund të vijojë më tej me analizën e vlerësimit të pretendimeve për cenimin e hierarkisë së akteve normative dhe të kërkesave të nenit 81 të Kushtetutës, nga ligji objekt shqyrtimi. Gjykata vëren se këto pretendime do të merreshin në konsideratë vetëm në plotësim të kushtit të kërkuar nga pika 2 e nenit 134 të Kushtetutës, pra vetëm nëse do të rezultonte se kërkuesi kishte një interes real të cenuar nga ligji i kundërshtuar. Për pasojë, kërkuesi nuk legjitimohet për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit, për nenet 81 dhe 116 të Kushtetutës.

Gjykata, bazuar në analizën në tërësi të pretendimeve të kërkuesit, arrin në përfundimin se ligji nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” nuk bie në kundërshtim me kërkesat e neneve 17, 35, 41 dhe 42 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 8 të KEDNJ-së dhe nenit 1 të protokollit shtesë të KEDNJ-së. Për këtë arsye, kërkesa e kërkuesit për shfuqizimin e ligjit objekt shqyrtimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, është e pabazuar dhe për rrjedhojë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzohet kërkesa për shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe KEDNJ, të ligjit nr.10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo (kryetar), Petrit Ploçi, Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Vitore Tusha, Sokol Berberi, Bashkim Dedja, Altina Xhoxhaj.

Anëtarë kundër: Sokol Sadushi

MENDIM PARALEL

Pavarësisht se në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, kam mendim të ndryshëm përse i takon shkaqeve për këtë qëndrim, për arsye se mendoj se kërkesa duhej rrëzuar për shkak të moslegjitimitit të kërkuarit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Mendimi im bazohet në këto arsye:

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) e ka vlerësuar çështjen e legjitimitit të kërkuarit (*locus standi*) si një nga aspektet kryesore që lidhen me iniciimin e gjykimit kushtetues të normës (kontrolli abstrakt).

Kushtetuta, në nenin 134/1, shkronja “f”, parashikon si subjekte që mund ta venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese edhe “organizatat e tjera”, ku përfshihen të gjitha ato shoqata, fundacione, sindikata ose organizime të tjera me karakter të ndryshëm, duke përfshirë edhe ato me karakter politik, që kanë qëllim mbrojtjen e interesave të grupeve të caktuara shoqërore. Pra, shoqatat legjitimohen *ratione personae* në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës.

Megjithatë, kjo e drejtë është e kushtëzuar, ajo mund të ushtrohet vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Vetëm nëse e përmbushin kushtin e kërkuar nga paragrafi 2 i nenit 134 të Kushtetutës, për të argumentuar “interesin e tyre” në një “çështje të veçantë”, subjektet e listuara në shkronjat “dh”, “e”, “ë” dhe “f” të nenit 134/1 legjitimohen *ratione materiae* për t'iu drejtuar Gjykatës në lidhje me prerogativën e saj për të vendosur, në këtë rast, mbi pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 25.7.2008*).

Gjykata ka theksuar se interesi duhet provuar dhe për këtë qëllim kërkuari duhet, së pari të saktësojë se në çfarë cilësie vepron kundër dispozitës së kundërshtuar dhe më pas të vërtetojë se në çfarë mënyre mund të preket në një aspekt të çfarëdoshëm të situatës së tij, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së tij dhe normës që kundërshton (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.16, datë 25.07.2008*). Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.2.2007; nr.11, datë 4.4.2007; nr.35, datë 10.10.2007; nr.41, datë 16.11.2007; nr.9, datë 19.3.2008; nr.16, datë 25.7.2008; nr.12, datë 28.4.2009*).

Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se vlerësimi, nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Në këtë kuptim, kërkuari duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin është krijuar ose veprimtarisë që kryen, dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat që kërkohet të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 25.7.2008; nr.9, datë 19.3.2008*). Për pasojë, vetëm fakti që dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë patur një efekt çfarëdo mbi kërkuarin nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkuarit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.31, datë 18.6.2010*).

Me anë të këtij detyrimi, për të provuar interesin konkret për çështjen kushtetuese të ngritur, synohet identifikimi i të drejtës së shkelur të subjektit, si rrjedhojë e antikushtetutshmërisë në përmbajtje të normës juridike të kundërshtuar. Pra, interesi konsiston te e drejta e shkelur, te *dëmi real* ose *potencial* dhe jo te premisat teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Për të vlerësuar legjitimitimin e subjektit, Gjykata përcakton fillimisht të drejtën kushtetuese të subjektit që pretendohet se i është cenuar nga norma konkrete e kundërshtuar para saj. Subjektet e parashikuara në nenin 134, pika 1 të Kushtetutës legjitimohen të kërkojnë antikushtetutshmërinë e normës juridike, në qoftë se vetë norma ka cenuar ndonjë të drejtë ose liri kushtetuese, nga ato që subjekti legjitimohet t'i mbrojë para Gjykatës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.20, datë 9.7.2009*).

Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata është vënë në lëvizje nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), një organizatë jofitimprurëse, e krijuar me vullnetin e lirë të anëtarëve të saj, e regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 19.07.2002. Bazuar në ligjin nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, me

organizata jofitimprurëse kuptohen shoqatat, fondacionet dhe qendrat, veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti (neni 3). Sipas nenit 10 të këtij ligji, në varësi të mënyrës së organizimit, organizatat jofitimprurëse ndahen në organizata jofitimprurëse me anëtarësi dhe pa anëtarësi. Organizata jofitimprurëse me anëtarësi janë shoqatat. Sipas nenit 39 të Kodit Civil, shoqata është person juridik që krijohet me vullnetin e lirë të pesë ose më shumë personave fizikë ose jo më pak se dy personave juridikë që ndjekin një qëllim të caktuar, të ligjshëm, në të mirë dhe në interes të publikut ose të anëtarëve të saj.

Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkët (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 10.10.2007*). Shoqatat paraqiten si organizime për realizimin e një interesi të një kategorie shoqërore. Ato individualizojnë në aktin e krijimit të tyre një kategori më të gjerë subjektsh, duke tentuar të paraqiten në këtë mënyrë si instrumente të afta, për të përmbushur interesin e atyre që i përkasin kategorisë së përcaktuar në aktin e krijimit. Megjithatë, për konceptin e interesit të një kategorie shoqërore nuk duhet të krijohen keqkuptime; nuk duhet të besojmë që kategoria shoqërore është një realitet i veçantë që nuk varet nga krijimi i marrëdhënies së shoqatës dhe që duhet të udhëheqë përcaktimin e interesit të shoqatës si interes i kësaj kategorie, pavarësisht nga vullneti i anëtarëve të shoqatës, ose që shoqata duhet të ndjekë interesin edhe të atyre që nuk bëjnë pjesë në shoqatë, por që i përkasin të njëjtës kategori shoqërore. Detyrimi i shoqatës, duke qenë kontratë, qëndron gjithmonë mjeti për realizimin e interesit të palëve; palët nuk realizojnë nëpërmjet kontratës interesin e kategorisë, por marrin pjesë në to me cilësinë e mbajtësit të interesit të kategorisë dhe asnjë element tjetër, përveç vullnetit të palëve, nuk mund të përcaktojë shtrirjen e kategorisë ose të vendosë mbi atë çka është në pajtim ose jo me interesin e shoqatës (*"E drejta Private" – Francesco Galgano, Luarasi University Press, Tiranë 2006, fq.731*).

Gjykata ka theksuar se interesi i një subjekti në një çështje, në kuptim të shkronjave "dh", "e" "ë", "f" të nenit 134 të Kushtetutës, do të quhet i justifikuar nëse arrin të provohet nga vetë kërkuksi se pasoja është e drejtpërdrejtë, pra rrjedh drejtpërdrejt nga akti objekt shqyrtimi, është aktuale dhe, sipas rastit, është e lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit ose organizatës përkatëse (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.40, datë 16.11.2007*). Kërkuksi legjitimohet për të paraqitur një kërkesë të tillë për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën në rast se ligji ndërhyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në të drejtat e tij, në interesat juridikë ose në pozicionin ligjor si person juridik. Interesat e veprimtarisë së kërkuksit, sipas statutit të tij, interesat individualë të anëtarëve të tij ose edhe interesi i përgjithshëm për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, a i japin atij të drejtën të paraqesë një kërkesë të tillë përpara Gjykatës? Në rastin në shqyrtim ndodhemi përpara një cenimi të drejtpërdrejtë dhe konkret apo gjendemi përpara një interesi ligjor të përgjithshëm dhe abstrakt, të cilin mund ta provojë çdokush?

Siç u përmend më sipër, shoqatat janë organizime ligjore ku mbizotëron interesi privat i përbashkët. Këto organizime kanë për qëllim të veprimtarisë së tyre realizimin e një interesi të një kategorie shoqërore dhe tentojnë të paraqiten si instrumente të afta për të përmbushur interesin e atyre që i përkasin kategorisë së përcaktuar në aktin e krijimit. Në këtë kuptim, në mënyrë që të provojë interesin e tij për çështjen kushtetuese të ngritur, KSHH-ja duhet të provojë se akti normativ i kundërshtuar ka sjellë pasoja të pafavorshme (ose ekziston një rrezik real për ardhjen e pasojave të tilla), të drejtpërdrejta mbi të, qofshin këto pasoja mbi veprimtarinë që kjo shoqatë ushtron sipas statutit (p.sh. kërkuksi pengohet nga dispozitat ligjore ta ushtrojë veprimtarinë përkatëse ose ligji vendos kufizime për ushtrimin e saj etj.), ose pasoja që prekin interesin e përbashkët të anëtarëve të shoqatës, ose edhe kategorisë që ajo përfaqëson, ose se norma/ligji ka cenuar ndonjë të drejtë a liri kushtetuese nga ato që subjekti legjitimohet t'i mbrojë para Gjykatës.

Rezultoni nga kërkesa paraqitur Gjykatës se KSHH-ja nuk ka arritur të identifikojë të drejtën që i cenohet nga zbatimi i ligjit të kundërshtuar. Dispozitat e këtij ligji nuk janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj këtij subjekti dhe nuk shtrijnë efekte mbi të ose mbi anëtarët e tij, por ato as nuk e prekin atë në mënyrë të pafavorshme dhe as nuk rrezikojnë t'i shkaktojnë një dëm çfarëdo. Zbatimi i këtyre dispozitave nuk sjell asnjë pasojë mbi veprimtarinë e subjektit, sipas parashikimeve të bëra në statut.

Risjell edhe njëherë në vëmendje jurisprudencën e kësaj Gjykate, e cila shprehet se interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak dhe interesi hipotetik nuk mund të pranohet. Pra, nuk mund të pranohet as arsyetimi se në mënyrë hipotetike anëtarët e shoqatës ose vetë kërkuesi si person juridik, mund të jenë subjekte të ligjit në të ardhmen, përse rreziku nuk është real, sepse dispozitat e ligjit të kundërshtuar nuk zbatohen ndaj tyre ose të paktën nuk u provua që ato të jenë zbatuar ndaj tyre dhe të kenë sjellë pasoja për ta.

Bazuar në statutin e kësaj shoqate, objekt i veprimtarisë së saj është:

- Vëzhgimi i gjendjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe zbatimi i parimeve të shtetit ligjor, denoncimi i çdo shkeljeje që bie ndesh me legjislacionin shqiptar dhe normat e së drejtës ndërkombëtare të njohura përgjithësisht.

- Kundërshtimi i çdo forme të diskriminimit të personit për shkak të bindjeve politike, besimit fetar, përkatësisë etnike, racës, gjuhës, pozitës shoqërore dhe ekonomike.

- Sensibilizimi i opinionit publik për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të ligjshme të shtetasve.

- Edukimi ligjor i shtetasve si me legjislacionin e brendshëm, edhe me atë ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut.

- Vëzhgimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve dhe të komuniteteve të tjera në Shqipëri në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në statut theksohet se, për realizimin sa më të mirë të këtyre objektivave, shoqata do të zbatojë programe në fushën e të drejtave të shtetasve; do të zbatojë normat kushtetuese dhe legjislacionin e vendit; do të tregohet kujdes i veçantë në përsosjen e legjislacionit vendas sidomos të dispozitave që garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve.

Duke e shqyrtuar çështjen e legjitimitetit të KSHH-së edhe në këtë kuptim, ky objekt i veprimtarisë nuk e legjitimon kërkuesin që të vërë në lëvizje Gjykatën sa herë që vlerëson se një dispozitë ligjore cenon të drejtat e njeriut, pa e provuar më parë konkretisht këtë cenim. Por edhe në rast se do t'i bënin një interpretim të zgjeruar objektit të veprimtarisë, KSHH-ja duhet të provojë pasojat konkrete që kanë ardhur nga zbatimi i ligjit; kjo si rezultat i veprimtarisë së tij vëzhguese. Pra, këto shkelje të pretenduara duhet të verifikohen gjatë veprimtarisë konkrete të këtij subjekti, e kryer qoftë me nismën e tij, qoftë si pasojë e ankesave të drejtuara kësaj shoqate. Kërkuesi jo vetëm që nuk arrin të provojë dëmin e shkaktuar ndaj këtij subjekti, si pasojë e zbatimit të ligjit të kundërshtuar, por nuk arrin as të provojë ardhjen e një dëmi real ndaj subjekteve ndaj të cilave zbatohet ky ligj, duke u shprehur në seancë plenare se nuk ka dijeni nëse ka filluar zbatimi i këtij ligji dhe çfarë pasojash ka sjellë ai.

Fakti që Gjykata ka legjitimuar më parë këtë subjekt, me arsyetimin se kjo shoqatë është e njohur për veprimtarinë e saj në mbrojtje të të drejtave të njeriut, nuk është i mjaftueshëm dhe as argument të favor të legjitimitetit edhe në rastin konkret. KSHH-ja, si organizatë jofitimprurëse, nuk ka ndonjë kompetencë kushtetuese ose ligjore për mbrojtjen e të drejtave të individëve, siç është rasti i institucionit të Avokatit të Popullit, funksioni kushtetues i të cilit është pikërisht mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme ose të parregullta të organeve të administratës publike, ku një mënyrë me të cilën ky organ realizon funksionin e tij është edhe vënia në lëvizje e Gjykatës për shfuqizimin e akteve normative që rezultojnë të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën. Megjithatë, edhe ky subjekt, në ndryshim nga sa rezulton nga jurisprudenca e Gjykatës përse i përket KSHH-së, në çdo rast duhet të provojë interesin e tij për të vënë në lëvizje Gjykatën, pra duhet të provojë se çështja kushtetuese e ngritur lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me funksionet e tij.

Përse parashtrova më sipër, jam e mendimit se kërkuesi nuk duhet të legjitimohej për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit nr.10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë".

ANËTARE

Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka pranuar legjitimitimin e pjeshëm të Komitetit Shqiptar të Helsinkit për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të drejtës së jetës private dhe të drejtës së pronës, ndërkohë që nuk e ka legjitimuar për pretendimin e shkëljes së hierarkisë së akteve normative, në bazë të nenit 81, pika 2 të Kushtetutës.

Për argumentimin e antikushtetutshmërisë së ligjit të sipërcituar, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka evidentuar shumë prej elementeve të procesit të rregullt ligjor, të cilët, Gjykata në vendimin e saj, i ka grupuar në të drejtën për t’u drejtuar gjykatës (*e drejta e aksesit*), në prezumimin e pafajësisë dhe në gjykatën e caktuar me ligj. Megjithëse shumica e ka legjitimuar kërkuesin, në lidhje me pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në përfundim, ka konkluduar për pabazueshmërinë e kërkesës së paraqitur.

Dy janë drejtimet kryesore, në të cilat bazohet kundërshtimi që gjyqtari në pakicë i bën qëndrimin të mbajtur nga shumica. Standardi i “*gjykatës së caktuar me ligj*” dhe “*legjitimitimi i kërkuesit*” për të ngritur pretendimin për miratimin e ligjit në kundërshtim me rregullimin kushtetues të shumicës, së cilësuar prej tre të pestave të anëtarëve të Kuvendit, kanë qenë të mjaftueshëm për të konkluduar shumica për shfuqizimin, në tërësinë e tij, si antikushtetues të ligjit objekt shqyrtimi.

1. Cenimi i elementit të “*gjykatës së caktuar me ligj*”, i argumentuar në kërkesë, por dhe në seancë plenare, si një ndër pretendimet kryesore të kërkuesit, nuk rezulton të ketë marrë përgjigje nga Gjykata, në vendimin e saj. Formulimi i përdorur nga shumica se “*kërkuesi nuk ka dhënë argumente bindëse që do të vinin në dyshim plotësimin e kërkesave të mësipërme që imponon standardi i “gjykatës së caktuar me ligj” nga Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda dhe në shkallë të dytë nga Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda*” nuk mendoj se është në koherencë me atë që vetë Gjykata ka shprehur që në krye të vendimit të saj, kur ka listuar pretendimet kryesore të kërkuesit.

Në mënyrë të përmbledhur, vetë shumica në vendimin e saj, ka evidentuar ndërmjet të tjerave se pretendimi i kërkuesit lidhet me cenimin që ligji i ka bërë parimit të juridiksionit gjyqësor, “*pasi në kundërshtim me ndarjen e juridiksionit gjyqësor në gjykatat penale dhe civile, cakton një gjykatë penale të gjykojë një proces civil.*” Kërkuesi i ka ngritur të gjitha pretendimet e tij në funksion të cenimit të së drejtës së çdo individi për t’u gjykuar “*nga një gjykatë kompetente e caktuar me ligj, si element i procesit të rregullt ligjor.*”

Detyrë e Gjykatës ishte t’i përgjigjej këtij pretendimi, të ngritur nga kërkuesi në nivel kushtetues, për standardin e “*gjykatës së caktuar me ligj*”, duke konkluduar për rrëzimin e saj në thelb. Në të vërtetë, qëndrimi që ka mbajtur shumica e ka lënë pa zgjidhje këtë pretendim kryesor të kërkuesit. Në rrethana të tilla, ndihem i obliguar si gjyqtar në pakicë, për të argumentuar qëndrimin tim për këtë standard kushtetues, të pretenduar nga kërkuesi dhe të konsoliduar tashmë në jurisprudencën kushtetuese shqiptare.

Shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e krijuar me ligj është një ndër elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor. Shprehja “*gjykatë e caktuar me ligj*”, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, reflekton parimin e shtetit të së drejtës. Një standard i tillë “mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështje konkrete” (*shih vendimin nr. 14, datë 17.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

Çdo gjykatë që shqyrton një çështje duhet të jetë e krijuar me ligj. Qëllimi i këtij standardi është të sigurojë se gjykimet nuk kryhen nga gjykata që krijohen për të vendosur për çështjen e një rasti të veçantë. Nocioni “*gjykatë*” karakterizohet në sensin material nga funksioni gjyqësor që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente kërkon që gjykata të ketë juridiksion, për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit. (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 23, datë 23.7.2009*).

Pikërisht, standardit të kompetencës së caktuar gjykatës nga ligji i është referuar Komiteti Shqiptar i Helsinkit, për të argumentuar cenimin që i kanë bërë të drejtës për një proces të rregullt ligjor, disa nga dispozita e ligjit objekt shqyrtimi. Në rregullimin normativ të nenit 3 të ligjit është përcaktuar juridiksioni i gjykatës penale ndaj pasurisë së personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie për kryerjen e disa krimeve të parashikuara në Kodin Penal. Neni 7 i këtij Kodi ka njohur Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda si gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesave për marrjen e masave parandaluese, si dhe ka përcaktuar njëkohësisht edhe përbërjen e trupit gjykues, në funksion të natyrës së çdo kërkesë. Në listën e veprave penale, të listuara në nenin 3 të ligjit objekt shqyrtimi, rezulton të jenë përfshirë disa prej krimeve që në ligjin nr.9110 datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda” dhe në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale nuk parashikohen si kompetencë lëndore e gjykatave për krimet e rënda. Konkretisht veprat penale të parashikuara nga nenet 230/c; 230/ç; 283; 114/a dhe 287 të Kodit Penal, që gjenden të parashikuara në nenin 3, e kanë zgjeruar, në kundërshtim me ligjet e sipërcituara, kompetencën e gjykatave për krimet e rënda, duke cenuar në të njëjtën kohë dhe standardin e gjykatës së caktuar me ligj. Gjykatat për krimet e rënda e kanë të përcaktuar kompetencën lëndore në mënyrë korrekte dhe shteruese në dy ligjet e sipërcituara. Për rrjedhojë, përcaktimi i kompetencës lëndore me një ligj të thjeshtë, që në hierarkinë e normave listohet pas Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit organik të gjykatës së krimeve të rënda, sjell implikime të standardit kushtetues të gjykatës së caktuar me ligj.

Nga ana tjetër, vetë kompetenca lëndore e gjykatës është e lidhur ngushtë edhe me kompozimin e trupit gjykues, të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështje konkrete. Neni 6 i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës për krimet e rënda” ka përcaktuar shqyrtimin prej këtyre gjykatave të çështjeve me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë. Ky është i vetmi format i përbërjes së trupit gjykues që ndiqet në shqyrtimin e të gjitha çështjeve nga gjykatat e krimeve të rënda dhe që i identifikon ato si gjykata të caktuar me ligj, në kuptim të standardit të procesit të rregullt ligjit. Neni 7 i ligjit, objekt shqyrtimi, në kundërshtim me këtë standard të vendosur nga ligji, e ndryshon përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me një ose tre gjyqtarë, në varësi të llojit të kërkesës, si dhe me tre gjyqtarë për Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.

Jurisprudenca kushtetuese ka nënvizuar se problemet e zbatimit dhe të interpretimit të ligjit, duke përfshirë edhe dispozitat për kompetencën, u takojnë në parim gjykatave të pushtetit gjyqësor, por tejkallimet e kompetencave janë marrë në shqyrtim nga Gjykata, kur shkeljet e ligjit procedural kanë cenuar të drejtën kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Në këtë kontekst, Gjykata ka nënvizuar se nocioni “ligj”, sipas nenit 42 të Kushtetutës, “përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave”. “Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar” në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, - ka nënvizuar Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.11, datë 23.4.2009 - “ajo nuk është e krijuar me ligj sipas kuptimit të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane.”

Këtyre standardeve, të vendosura nga vetë jurisprudenca e Gjykatës, u është referuar kërkuesi, por që shumica në vendimin e saj nuk i është përgjigjur. Pretendimit të kërkuesit se gjykatës për krimet e rënda i është ndryshuar përbërja e trupit gjykues, si dhe i është zgjeruar juridiksioni gjyqësor me një ligj të thjeshtë që kundërshton haptazi ligjin e saj organik, por edhe Kodin e Procedurës Penale, shumica i është përgjigjur nëpërmjet mosdhënies së përgjigjes. Një arsyetim i Gjykatës për shqyrtimin në thelb të pretendimit të “gjykatës së krijuar me ligj”, nuk do të më vendoste në pakicë, për arsye se ligjin objekt shqyrtimi, do ta shfuqizonte si antikushtetues.

2. Për legjitimitimin e kërkuesit, për të ngritur pretendimin e cenimit të hierarkisë së akteve normative, në kuptim të nenit 81, pika 2 të Kushtetutës.

Shumica i është referuar qëndrimit të konsoliduar të Gjykatës, për legjitimitimin e kushtëzuar të subjekteve të listuara në pikën 2 të nenit 134 të Kushtetutës, por duke i dhënë një tjetër kuptim. Nga njëra anë, shumica ka arritur në përfundimin “se kërkuesi legjitimohet si subjekt për të inicuar kontrollin kushtetues të ligjit objekt shqyrtimi, lidhur me pretendimet për cenim të të drejtave për një proces të rregullt ligjor, të drejtës së pronës dhe të së drejtës për mbrojtjen e jetës private”, ndërkohë që, nga ana tjetër, ka konkluduar se këto pretendime do të merreshin në konsideratë

“vetëm nëse do të rezultonte se kërkuesi kishte një interes real të cenuar nga ligji i kundërshtuar.”
Për rrjedhojë, shumica nuk e ka legjitimuar kërkuesin për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit për nenet 81, pika 2 dhe 116 të Kushtetutës.

Një konkluzion i tillë nuk duket koherent, për arsye se të provuarit e interesit në çështjen në shqyrtim nuk lidhet domosdoshmërisht me pranimin e shkeljes. Pikësëpari, Gjykata ka për detyrë të vërtetojë ekzistencën e interesit për çështjen, për të konkluduar për pranueshmërinë për shqyrtim të pretendimit të ngritur. Prania e interesit për çështjen nuk është e kushtëzuar me pranimin në përfundim të gjykimit edhe të pretendimit të ngritur. Çështja e pranimit të legjitimitimit lidhet me fillimin e shqyrtimit gjyqësor dhe jo edhe me pranimin e kërkesës. Mund të ketë interes pala për çështjen konkrete, por argumentin që përdor për të provuar shkeljen mund ta ketë të gabuar. Në kushte të tilla Gjykata nuk vendos moslegjitimitimin e kërkuesit, sepse një gjë të tillë e ka pranuar më parë, por shprehet për pabazueshmërinë e pretendimit, të ngritur nga një kërkues me legjitimim.

Në rastin në shqyrtim, shumica e Gjykatës ka legjitimuar Komitetin Shqiptar të Helsinkit përsa i përket pretendimit për proces të parregullt ligjor. Pasi ka arritur në përfundimin për pabazueshmërinë në thelb të këtij pretendimi ka konkluduar edhe për mos legjitimitimin e kërkuesit për pretendimin e cenimit të hierarkisë së akteve normative, në kuptim të nenit 81 të Kushtetutës. Një arsytim i tillë nuk është korrekt.

Për të vlerësuar legjitimitimin e subjektit, të cilit i kërkohet të justifikojë interesin e tij në lidhje me çështjen, Gjykata ka vënë theksin te përcaktimi i së drejtës kushtetuese ose ligjore të subjektit, i cili pretendon se i është cenuar për shkak të antikushtetutshmërisë së normës konkrete të kundërshtuar para saj. Gjykata ka argumentuar “se subjektet e parashikuara në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës nuk legjitimohen të kërkojnë antikushtetutshmerinë e normës juridike duke paraqitur si argument ekzistencën e veseve formale, në qoftë se vetë norma nuk ka cenuar ndonjë të drejtë a liri kushtetuese nga ato që subjekti legjitimohet t’i mbrojë para Gjykatës” (*shih vendimin nr. 25, datë 5.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

Nga interpretimi *a contrario* që i bëhet këtij qëndrimi, rezulton se Komiteti Shqiptar i Helsinkit pretendon se janë cenuar të drejta e liri kushtetuese nga ato që mbrohen para Gjykatës Kushtetuese. Vetë shumica ka pranuar të legjitimojë kërkuesin dhe të shqyrtojë pretendimet e tij për disa të drejta kushtetuese, si të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të drejtën e pronës dhe të drejtën për mbrojtjen e jetës private. Për rrjedhojë, shumica i ka dhënë legjitimim kërkuesit edhe për ngritjen e pretendimit të cenimit të hierarkisë së akteve normative, në kuptim të nenit 81, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës, por që padrejtësisht ka mbetur pa përgjigje. Nëse shumica do të pranonte shqyrtimin edhe të këtij pretendimi, ajo nuk do të mund t’i shmangej shpalljes së antikushtetutshmërisë së normës ligjore për shkak të mosmiratimit të saj nga tre të pestat e anëtarëve të Kuvendit (*shih vendimet nr. 25, datë 5.12.2008, nr. 3, datë 5.2.2010 dhe nr.1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka tashmë praktikë të konsoliduar për respektimin e kriterëve formale dhe materiale që vendos Kushtetuta, të cilat duhen respektuar gjatë procedurës ligjvënëse. Një nga kriteret është edhe miratimi i një ligji që kërkon shumicë të cilësuar, në respektim të nenit 81, pika 2 të Kushtetutës (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë.3.5.2007 dhe nr.25, datë 5.12.2008*).

Pretendimi i kërkuesit për cenimin që i është bërë nga ligji objekt shqyrtimi, hierarkisë së akteve normative, në kuptim të nenit 81 të Kushtetutës, është i fokusuar kryesisht në aspekte të procedurës, kompetencës dhe kriterëve për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe trafikim. Këto rregullime vijnë në kundërshtim të hapur me ligjet që kërkojnë një shumicë të cilësuar. Mosrespektimi nga ky ligj i dispozitave të Kodit të Procedurës Penale dhe të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës për krimet e rënda”, krijon një problematikë me rrjedhoja kushtetuese për respektimin e të drejtës për t’u gjykuar nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”, si dhe të rregullave mbi të cilën funksionon një shtet i së drejtës.

Nxjerrja e këtij ligji kaq të rëndësishëm, por në shkelje të standardeve kushtetuese, nuk arrin t'i shërbejë as qëllimit, për të cilin ai është miratuar. Prandaj, shpallja si antikushtetues i ligjit objekt shqyrtimi dhe miratimi nga ligjvënësi i një ligji tjetër, në respekt të normave kushtetuese, do të ishte zgjidhja më e drejtë për të parandaluar dhe për të goditur krimin e organizuar dhe trafikimin, nëpërmjet marrjes së masave parandaluese kundër pasurisë.

ANËTAR
Sokol Sadushi

KËRKESË
Nr.701/1, datë 24.2.2011
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i shkollës së re 9-vjeçare publike, në lagjen “Besëlidhja”, Lezhë, ku subjekti kërkues i këtij objekti është bashkia Lezhë.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët, preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit. të llogaritur nga komisioni i posaçëm për procedurat e shpronësimit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, me adresë: Rruga e Durrësit, nr.23, Tiranë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SHKOLLËS SË RE 9-VJEÇARE PUBLIKE, NË LAGJEN “BESËLIDHJA” LEZHË

Pronari	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. truall m²	Çmimi në lekë/m²	Vlera e tokës (lekë)	Vlera totale e shpronësimit (lekë)
Adlije Rexhep Hafizi	8632	4/44	72.75	20 000	20 000	1 455 000
Hasan Ramiz Hafizi	8632	4/44	72.75	20 000	20 000	1 455 000
Remzije Kamber Hafizi	8632	4/44 4/25	145.5	20 000	20 000	2 910 000
Arjan Bahri Hafizi	8632	4/44 4/25	145.5	20 000	20 000	2 910 000
Violeta Ramiz Hafizi	8632	4/44	72.75	20 000	20 000	1 455 000
Remzie Isa Hafizi	8632	4/44 4/25	291	20 000	20 000	5 820 000
Genci Ramiz Hafizi	8632	4/44	72.75	20 000	20 000	1 455 000
			873			17 460 000

Vlera totale e këtij shpronësimi është 17 460 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 10.3.2011
Doli nga shtypi më 12.3.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 48 lekë